

	<p style="text-align: center;"><b>Republika e Kosovës</b>  <b>Republika Kosova –</b>  <b>Republic of Kosovo</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Komuna e Prishtinës</b>  Opština Priština –Municipality  of Prishtina</p>	<p style="text-align: center;">PRISHTINA</p> 
---	---	--

<b>Datë/a:</b>	19.09.2018
<b>Për/ Za/ To:</b>	" INFOSOFT SYSTEMS , Prishtinë
<b>CC:</b>	Departamenti i Prokurimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2 ) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 17.09.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "" INFOSOFT SYSTEMS", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Furnizim me pajisje të TI-së- Server, Kompjuter,Llaptop**", me Nr. të Prok: **616-18-050-121**nxjerr:

## V E N D I M

1. Refuzohet në tërësi si e pa e bazuar kërkesa për rivlerësim e parashtruar nga Operatori Ekonomik "" INFOSOFT SYSTEMS" të dt. 17.09.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Furnizim me pajisje të TI-së- Server, Kompjuter,Llaptop**", me Nr. të Prok: **616-18-050-121**, kundër Vendimit të AK -së, të datës **11.09.2018**.
2. Mbetet në fuqi vendimi i AK datë: 11.09.2018.
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që aktivitetin e prokurimit me titull "**Furnizim me pajisje të TI-së- Server, Kompjuter,Llaptop**", me Nr. Brendshëm **616 18 50 121** ta vazhdojë me vendimin për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

## A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 16.07.2018 ka bërë njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimiti: **“Furnizim me paisje te TI-së- Server, Kompjuter,Llaptop”,** me Nr. Brendshëm 616 18 50 121, procedura e hapur.

Hapja e ofertave nga Autoriteti Kontraktues është bërë me datë: 06.08.2018. Janë dorëzuar gjithsej 6 oferta aktiviteti ka qene i ndare ne dy lote pa kufizim te shpërblimit per numer te loteve. Autoriteti Kontraktues ka respektuar të gjitha dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik lidhur me mbarë vajtjen dhe ecurinë e procesit të hapjes dhe vlerësimit të tenderëve.

Me datë 11.09.2018, Autoriteti Kontraktues ka njoftuar OE lidhur me rezultatet e aktivitetit te prokurimit duke dorëzuar Letrat Standarde për tenderuesit e suksesshëm/pasuksesshëm dhe eliminuar.

OE““ INFOSOFT SYSTEMS, me dt. 17.09.2018, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim., kundër vendimit te AK , në të cilin theksohet se AK ka *shkelur dispozitat e LPP, respektivisht:*

Neni 7: Barazia ne trajtim/Jo-Diskriminimi

Neni 59: Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

Neni:28: Specifikimi teknikë

### I. Baza ligjore

Ne lidhje me dispozitat e shkelura te LPP-se për te cilat pretendon OE “““ INFOSOFT SYSTEMS””, Autoriteti Kontraktues sqaron se ka bërë vlerësimin e tenderëve ne përputhje te plote me Ligjit për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, dhe njëkohësisht hedhë poshtë te gjitha pretendimet e OE.

1. **Neni 7: Barazia ne trajtim/Jo-Diskriminimi** - sipas këtij neni AK është i obliguar qe do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese, gjë te cilën AK e ka respektuar, duke trajtuar te gjithë OE ne mënyre te barabarte, dhe ka shpërblyer me kontrate OE qe ka përmbushur te gjitha kërkesat e parashtruara ne DT.
2. **Neni 59 “Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve”** – sipas këtij neni AK është i obliguar qe do vlerësoj tenderët ne përputhje me kërkesat parashtruara ne DT,

gjë te cilën AK e ka respektuar.

3. Neni 28 "Specifikimi Teknik"- sipas këtij neni AK do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka përmbushur kërkesat minimale te përcaktuar te Aneksit 1 te dosjes se tenderit.

### Pretendimi #1 i OE

OE i shpërblyer me kontratë nuk ka plotësuar Aneksin 6 Lista e Kontratave te realizuara ne tre vitet e fundit.

### Arsyetimi i AK

AK vlerëson se OE i shpërblyer me kontratë plotëson kriterin e përcaktuar pasi qe ka dorëzuar nje liste te kontratave qe përmbana te gjitha te dhënat e kërkuara.

# BOTEK

Kontrata të ngjashme të realizuara

NR.	A.K.	TITULLI KONTRATËS	VLERË	DATA	REFERENCA
1	Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"	Furnizim me pajisje laboratorike për FIEK dhe të tjera	€ 69,618.20	20.10.2017	90400/17/034/121
2	Komuna e Prishtinës	Furnizimi me radio dore dhe pajisje tjera per radio dore: bateri, antena, mikrofoni dore, ribushitës dhe varësë	€ 31,920.00	04.07.2017	616/17/027/121
3	Universiteti "Haxhi Zeka" Pejë	Furnizim me pajisje elektronike nga projekti Euforia	€ 159,130.00	06.07.2016	208-16-007/111
4	Ministria e Punëve dhe Mirëqenies Sociale	Furnizim me pajisje teknologjike informatike për nevojat e MPMIS	€ 67,367.00	27.01.2015	209/14/033/121
5	Policia e Kosovës	Furnizim me pajisje dhe pjesë elektronike per TI, LOT 1: Pjesë elektronike për kompjuterë dhe laptop	€ 23,390.00	22.10.2015	214/16/076/121

Blend Arifaj  
Mësoxher i projektit

16 qershor 2018



BOTEK s.p.a. "Agjensia Kosoviane" (Bota) LLC, Aktori 1 - 11111, 09000 Prishtinë, Republika e Kosovës.  
Tëni +383 (0)38 26 29 20 / 50, faks +383 (0)38 21 54 15, e-mail info@botech.com / Webj: [www.botech.com](http://www.botech.com)

### Pretendimi #2 i OE

Eshte kerkuar RAM up to 16 GB , modeli i ofruar VASTRO 16-3568 ne baze te broshurave te prodhuesit perkrah vetem RAM "up to 8GB"

### Arsyetimi i AK

### Pretendimi #3 i OE

Nuk suporton SATA III (6Gb/s) drive, sipas broshurave te Dell.

### Arsyetimi i AK

### Pretendimi #4 i OE

Mungon Specifikimi teknike dhe broshurat per te gjitha produktet. Per kete RRUOP sugjeron se tenderi duhet te refuzohet. Kompania Botek nuk ka ofruar as specifikim teknik te produkteve dhe as broshura per te njjetat. Ajo ka vendosur vetem modelin e produktit te ofruar duke i vene pefundimi tij specifikat teknike te kerkuara nga autoriteti kontraktues , por jo edhe specifikat perkatese te produkteve. Duke e konsideruar kete si manipulim ne mendojme se OE " Botek" ka bere deklarimin e rrejshem per perputhshmerine e specifikave teknike pasi nuk ka ofruar asnjë dëshmi te produkteve te ofruara,kjo vertetohet edhe me produktin e lartepemendur DELL VOSTRO 15-3568 loptop i cili eshte ofruar si pergjigje ndaj kerkeses per LAPTOP i3 brand name i cili nuk i ploteson specvifikimet teknike te kerkuar. Gjithashtu , per te njjeten arsye qe ka eliminuar OE Infosoft Systems per mos ofertim te duhur per PC i7 Tower, e ka shperblyer OE Botek edhe pse edhe ai nuk ka qene i pergjegjshem pasi modelet e fertuara jane mini tower (MT).

### Arsyetimi i AK

### Pretendimi #5 i OE

Eshte Ofruar toner kompatibil , ne baze te specifikimeve teknike nuk lejohet toner kompatibil per kete produkt, prandaj konsiderojme se oferta e cilësuar si e pergjegjshem nga Autoriteti Kontraktues nuk eshte e tille.

### Arsyetimi i AK

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

*Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.*

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

---